1. Të mos miratojë uljen e tarifës vjetore të studimit në masën 50% për vitin akademik 2021-2022, për studentët e ciklit të dytë të studimeve, Master Profesional dhe Master Shkencor, sipas listës emërore bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohen Fakultetet e Universitetit "Fan S. Noli" Korçë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE E BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Alketa Zallëmi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 951 Prot.

Korçë, më 09.06.2022

VENDIM

Nr. 223, datë 09.06.2022

PËR

MIRATIMIN E KRITEREVE, DOKUMENTACIONIT DHE PROCEDURAVE TË
PUNËSIMIT PËR POZICIONIN E PUNËS "ADMINISTRATOR" I UNIVERSITETIT
"FAN S. NOLI", KORÇË

Bazuar në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 49, pika f), Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 09/06/2022,

VENDOSI:

Kandidatët konkurrentë për Administrator në Universitetin "Fan S. Noli", Korçë" duhet të plotësojnë këto kritere të përgjithshme:

1. Të ketë formim universitar, së paku në nivelin "Master i Shkencave", në fushën e ekonomisë ose të drejtësisë.
2. Të ketë përvojë pune minimalisht 7 vjet, disa prej të cilave në pozicione drejtuese në sektorin publik apo privat.
3. Të paraqesë të paktën 2 letra rekomandimi nga eksperiencia të mëparshme pune.
4. Të mos ketë papajtueshmëri në kuptim të ligjit nr. 10034 datë 22.12.2008 "Për pastërtinë e figurës së funksionarëve të lartë të administratës publike dhe të të zgjedhurve" dhe ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".
5. Të ketë njohuri të mira të një prej 5 gjuhëve të huaja të BE, vërtetuar me certifikatat ndërkombëtare të njohura nga MAS, ose të mbrojtur pranë Fakultetit të gjuhëve të huaja në Tiranë. Nëse ka fituar diplomë të kryer në një nga këto gjuhë, kjo shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri, sipas ligjit 80/2015, Neni 76, pika 4.
6. Të mos ketë masa disiplinore në fuqi nga punëdhënësi i mëparshëm si dhe të mos jetë pezulluar, liruar apo shkarkuar nga organet e Vettingut.
7. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata dhe të mos jetë marrë masë ndëshkuese administrative nga autoritetet kompetente.

Kandidatët konkurrentë për Administrator në Universitetin "Fan S. Noli", Korçë" preferohet të plotësojnë edhe këto kritere të veçanta:

1. Të ketë përvojë pune në hartimin e buxheteve, menaxhimin e fondeve dhe koordinim me partnerë mbështetës të sektorit.
2. Të ketë eksperiencë menaxhimi organizatash apo institucionesh në administratën publike dhe/ose në sektorin privat të paktën 4 vjet në nivele të larta drejtuese.
3. Të zotërojë aftësi të mira drejtuese, menaxhuese, raportuese dhe aftësi të punës në grup.
4. Të përdorë programet bazë të kompjuterit dhe Windows.
5. Kualifikimet si, diplomë e një Masteri të dytë në fushat e sipërpërmendura, Master Ekzekutiv apo Doktoraturë konsiderohen të rëndësishme.

Kandidatët konkurrentë të përzgjedhur për Administrator në Universitetin "Fan S. Noli", Korçë, do të intervistohen nga Bordi i Administrimit, proces gjatë të cilit duhet të demonstron:

1. Njohuri të legjislacionit sektorial në fushën e arsimit të lartë.
2. Njohuri për ligjin "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" dhe ligjin "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë".
3. Njohuri të sistemit të arsimit të lartë.
4. Aftësi të mira analitike, punës në grup dhe aftësi prezantuese.
5. Aftësi për të paraqitur një plan konceptual për mënyrën se si do të realizojnë drejtimin dhe zhvillimin e universitetit.
6. Prezantimi i planit konceptual për administrimin e universitetit do të jetë i ndërtuar në programin Power Point, dhe do të prezantohet në gjuhën angleze deri në 10 minuta.

Kandidatët konkurrentë për Administrator në Universitetin "Fan S. Noli", Korçë duhet të paraqesin këtë dokumentacion:

1. Kërkesë me shkrim.
2. Curriculum Vitae.
3. Dokument Identifikimi.
4. Diplomë e studimeve universitare "Bachelor" dhe pasuniversitare "Master Shkencor" (fotokopje e noterizuar). Për diplomat e marra në Universitetet e huaja duhet të dorëzohet fotokopje e noterizuar e certifikatës së njohjes nga organi kompetent; njehsimin e nivelit të diplomës nga MAS.
5. Listë notash origjinale ose fotokopje e noterizuar.
6. Deklaratë individuale se kandidati nuk ka papajtueshmëri në kuptim të ligjit nr. 10034 datë 22.12.2008 "Për pastërtinë e figurës së funksionarëve të lartë të administratës publike dhe të zgjedhurve" dhe ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".
7. Dëshmi e zotërimit të një prej 5 gjuhëve të huaja të BE, sipas praktikave të pranura nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.
8. Letrat e referencës nga punëdhënësit e mëparshëm (përbajnë të dhënat e referuesit), të cilat provojnë vlerësimet pozitive në punë.

9. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet, arsimin shtesë, të cilat mund të shërbejnë për verifikimin e kriterëve preferencialë.
10. Diplomat, certifikatat, gradat e titujt e fituar në institucione të huaja arsimore, të shoqërohen me certifikatën/vërtetimin e njëhësit, bazuar në nenin 92, pika 3 të Ligjit nr. 80/2015 datë 22.07.2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë".

Dorëzimi i dokumentacionit:

1. Kandidatët e interesuar, duhet të paraqesin dokumentacionin e kërkuar brenda 14 ditë pune nga e nesërmeja e shpalljes së konkursit në Agjensinë e Prokurimit Publik.
2. Dokumentat dorëzohen në rrugë postare në adresën: Universiteti "Fan S. Noli", Shëtitore "Rilindasit", Korçë ose dorazi pranë zyrës së Protokoll Arkivës së UNIKO, brenda afatit të përcaktuar në shpalljen publike të Agjensisë së Prokurimeve Publike.
3. Nuk do të pranohet dokumentacion pas datës së përcaktuar në njoftimin e APP-së.

Publikimi i njoftimit:

1. Pas miratimit të kriterëve dhe procedurave për zgjedhjen e administratorit të UK nga Bordi i Administrimit, Bordi i Administrimit bën njoftim për shpallje në Agjensinë e Prokurimit Publik (APP).
2. Ngarkohen strukturat përkatëse në Rektorat të publikojnë njoftimin në faqen zyrtare të UK dhe të organizojnë marrjen në dorëzim të dokumentacionit nga konkurrentët dhe përcjelljen e tyre në Senatin Akademik.
3. Sipas ligjit nr. 80/2015, neni 51, pika 2, lista e kandidaturave që plotësojnë kriteret e miratuara dhe të shpallura nga Bordi i Administrimit, miratohet nga Senati Akademik brenda 15 ditëve nga përfundimi i afatit të dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatët. (Të vihet në dispozicion lista e plotë e konkurrentëve dhe lista e kandidatëve të kualifikuar pranë Bordit të Administrimit).
4. Bordi i Administrimit organizon procesin e intervistimit të kandidatëve, brenda 15 ditëve nga miratimi i listës së kandidatëve që plotësojnë kriteret e përgjithshme nga Senati Akademik.
5. Kandidatët konkurrentë për Administrator në Universitetin e Korçës do të vlerësohen sipas pikëzimit, ku kriteret e përgjithshme vlerësohen deri në 20 pikë; kriteret e veçanta (preferencialë) vlerësohen deri në 40 pike dhe procesi i intervistës vlerësohet deri në 40 pikë.
6. Bordi i Administrimit në Universitetin e Korçës zgjedh kandidaturën fituese për pozicionin e punës Administrator i UK me 3/5 e votave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE E BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Alketa Zallëmi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 952 prot.

Korçë, më 09/06/2022

VENDIM

Nr. 244, datë 09/06/2022

PËR

**MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË REGJISTRIN E PARASHIKIMEVE
TË PROKURIMEVE PUBLIKE**

Bordi i Administrimit i mbledhur në datën 09.06.22 pas diskutimit në lidhje me ndryshimet e Regjistrit të parashikimeve të prokurimeve publike, bazuar në ligjin nr.80/2015 datë 22.07.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të lartë në Republikën Shqipërisë", neni 49 pika 1 si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", nenit 3, pika 7,

VENDOSI

1. Miratimin e ndryshimeve të regjistrit të parashikimeve të prokurimeve publike për objektin e prokurimit si më poshtë :

Pershkrimi i zerave te regjistrit	Pakesim vlera me TVSH	Shtese vlera me TVSH
Softë Informatike me karakter te pergjithshem	800,000 (te ardhurat)	
Dixhitalizimi I Fondit te Bibliotekes Fan S. Noli		800,000 (te ardhurat)
		14,000,000 (buxhet)

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Alketa Zallëmi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 953 Prot.

Korçë, më 09.06.2022

VENDIM
NR. 245 DATË 09.06.2022

PËR
PËRFITIMIN E BURSËS NGA STUDENTËT, SIPAS PËRCAKTIMEVE TË VKM NR. 903, DATË
21.12.2016, "PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR PËRFITIMIN E BURSIVE NGA FONDI I
MBËSHTETJES STUDENTORE, PËR STUDENTËT E SHKËLQYER, STUDENTËT QË STUDIOJNË NË
PROGRAME STUDIMI NË FUSHAT PRIORITARE DHE STUDENTET NË NEVOJË"
(e ndryshuar)

Bazuar në VKM Nr. 903, datë 21.12.2016, "Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore, për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programet studimi në fushat prioritare në nevojë", i ndryshuar, Bordi i Administrimit, i mbledhur në datën 09.06.2022, pasi shqyrtoi dokumentacionin vërtetues për statusin ligjor, të paraqitur nga studentë të vitit I, II dhe III të ciklit të parë të studimeve (Bachelor) dhe nga studentët e vitit I dhe II, të programeve të studimeve profesionale,

VENDOSI:

1. Të miratojë përfitimin e bursës për vitin akademik 2021-2022, për studentët e vitit I, II dhe III, të ciklit të parë të studimeve, "Bachelor" dhe nga studentët e vitit I dhe II, të programeve të studimeve profesionale, sipas listave emërore bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE E BORDIT TE ADMINISTRIMIT





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 954 Prot.

Korçë, më 09.06.2022

VENDIM

Nr. 276, datë 09.06.2022

PËR

PËR FITIMIN E PËRJASHTIMIT NGA TARIFA VJETORE E SHKOLLIMIT PËR STUDENTËT, SIPAS PËRCAKTIMEVE TË VKM-SË NR. 269, DATË 29.03.2017, "PËR PËRCAKTIMIN E KATEGORIVE TË INDIVIDËVE QË PLOTËSOJNË KRITERET E PRANIMIT NË NJË PROGRAM TË CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE, NË NJË PROGRAM TË INTEGRUAR TË STUDIMEVE OSE NË NJË PROGRAM TË STUDIMEVE PROFESIONALE, QË PËRJASHTOHEM NGA TARIFA VJETORE E SHKOLLIMIT", (I NDRYSHUAR)

Bazuar në VKM-në nr. 269, datë 29.03.2017, "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të integruar të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit" (i ndryshuar), Bordi i Administrimit, pasi shqyrtoi dokumentacionin vërtetues për statusin ligjor, të paraqitur nga studentë të vitit I, II dhe III të ciklit të parë të studimeve (Bachelor) dhe studentë të vitit I dhe II të programeve të studimeve profesionale, forma e studimeve me kohë të plotë,

VENDOSI:

1. Të miratojë përjashtimin nga tarifa vjetore e studimeve për vitin akademik 2021-2022, për studentët e ciklit të parë të studimeve, "Bachelor dhe të programeve të studimeve profesionale" sipas listës emërore bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohen Fakultetet e Universitetit "Fan S. Noli" Korçë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE E BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Alketa Zallëni





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1060 Prot.

Korçë, më 27.06.2022

VENDIM

Nr. 288, datë 27.06.2022

PËR

PËRFITIMIN E PËRJASHTIMIT NGA TARIFA VJETORE E SHKOLLIMIT PËR STUDENTËT, SIPAS PËRCAKTIMEVE TË VKM-SË NR. 269, DATË 29.03.2017, "PËR PËRCAKTIMIN E KATEGORIVE TË INDIVIDËVE QË PLOTËSOJNË KRITERET E PRANIMIT NË NJË PROGRAM TË CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE, NË NJË PROGRAM TË INTEGRUAR TË STUDIMEVE OSE NË NJË PROGRAM TË STUDIMEVE PROFESIONALE, QË PËRJASHTOHEM NGA TARIFA VJETORE E SHKOLLIMIT", (I NDRYSHUAR)

Bazuar në VKM-në nr. 269, datë 29.03.2017, "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të integruar të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit" (i ndryshuar), Bordi i Administrimit, pasi shqyrtoi dokumentacionin vërtetues për statusin ligjor, të paraqitur nga studentë të vitit I, II dhe III të ciklit të parë të studimeve (Bachelor) dhe studentë të vitit I dhe II të programeve të studimeve profesionale, forma e studimeve me kohë të plotë,

VENDOSI:

1. Të miratojë përjashtimin nga tarifa vjetore e studimeve për vitin akademik 2021-2022, për studentët e ciklit të parë të studimeve, "Bachelor dhe të programeve të studimeve profesionale" sipas listës emërore bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohen Fakultetet e Universitetit "Fan S. Noli" Korçë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE E BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Alketa Zallëmi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1220 Prot.

Korçë, më 26.07.2022

VENDIM
NR. 328, DATË 26.07.2022

PËR
MIRATIMIN E NXJERRJES JASHTË PËRDORIMIT TË AKTIVEVE
TË PROPOZUARA DHE TË VLERËSUARA PËR TU NXJERRË JASHTË
PËRDORIMIT

Bordi i Administrimit, i mbledhur sot në datën 26 /07/2022, pasi u njoh me relacionin e paraqitur nga Administratori në lidhje me nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të propozuara dhe të vlerësuara për tu nxjerrë jashtë përdorimit, mbështetur në Udhëzimin nr. 30 i Ministrisë së Financave datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të miratojë nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të propozuara dhe të vlerësuara për tu nxjerrë jashtë përdorimit sipas relacionit dhe pasqyrave bashkëngjitur.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE E BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Alketa Zallëmi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1221 Prot.

Korçë, më 26.07.2022

VENDIM

Nr. 329, datë 26.07.2022

PËR

**NJE NDRYSHIM NE VENDIMIN NR.273 DATE 09/06/2022 TE BORDIT TE
ADMINISTRIMIT**

**PER "MIRATIMIN E KRITEREVE, DOKUMENTACIONIT DHE PROCEDURAVE TË
PUNËSIMIT PËR POZICIONIN E PUNËS "ADMINISTRATOR" I UNIVERSITETIT
"FAN S. NOLI", KORÇË"**

Bazuar në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "*Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë*", neni 49, pika f), Statutit të Universitetit "Fan S. Noli" Korçë, si dhe Relacionit Nr. 1005 prot., datë 16.06.2022 të Senatit Akademik mbi Vendimin Nr. 273 datë 09/06/2022, "Për miratimin e kriterëve, dokumentacionit dhe procedurave të punësimit për pozicionin e punës "Administrator", Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 26/07/2022,

VENDOSI:

1. Të pranojë kërkesën e Senatit Akademik referuar Relacionit Nr. 1005 prot., datë 16.06.2022, pika 5, kriteret e veçanta (të hiqet kërkesa si kriter i veçantë për "Master Ekzekutiv")
2. Të pranojë kërkesën e Senatit Akademik referuar Relacionit Nr. 1005 prot., datë 16.06.2022 pika 6, procesi i intervistimit (Të hiqet kërkesa për prezantimin në gjuhën angleze të planit konceptual për administrimin e universitetit ndërtuar në programin Power Point)
3. Të bëhet njoftimi për shpallje në Agjensinë e Prokurimit Publik (APP) Vendimi Nr. 273 datë 09/06/2022, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE E BORDIT TE ADMINISTRIMIT

Alketa Zallëmi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1222 Prot.

Korçë, më 26.07.2022

VENDIM

NR. 330, DATË 26.07.2022

PËR

MIRATIMIN E KRITEREVE DHE PROCEDURËS PËR FINANCIM TË BOTIMEVE
DHE PJESËMARRJES NË KONFERENCA SHKENCORE TË STAFIT AKADEMIK TË
UNIVERSITETIT "FAN S. NOLI", DUKE FILLUAR NGA VITI AKADEMIK 2022 - 2023

Bazuar në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "*Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë*", neni 3, pika 3/ c, Udhëzimin nr. 19, datë 31.05.2011 "*Për detajimin e buxhetit të institucioneve publike të arsimit të lartë në programin 'Për kërkimin fundamental dhe ekselencë'*", VKM-së nr. 329, datë 12.04.2017 "*Për statusin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik*" pika 18, si dhe Vendimin e Senatit Akademik Nr.298, datë 07.07.2022, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 26/07/2022,

VENDOSI:

1. Të miratojë kriteret dhe procedurën për financim të botimeve dhe pjesëmarrjes në konferenca shkencore të stafit akademik të Universitetit "Fan S. Noli" Korçë, duke filluar nga viti akademik 2022 – 2023.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE E BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Alketa Zallëmi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1223 Prot.

Korçë, më 26.07.2022

VENDIM

Nr. 334 datë 26.07.2022

PËR

**MIRATIMIN E TARIFAVE VJETORE TË SHKOLLIMIT PËR ÇDO
PROGRAM STUDIMI DHE TË TARIFAVE TË RREGJISTRIMIT PARAPRAK
PËR VITIN AKADEMIK 2022 - 2023**

Bazuar në VKM nr. 288, datë 21.05.2018 "Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë", i ndryshuar, VKM nr. 866, datë 23.10.2015, "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 638, datë 22.07.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për kuotat e pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë në programet e studimeve, në programet e studimeve jouniversitare profesionale dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, si dhe tarifat e shkollimit për vitin akademik 2015-2016" si dhe Vendimin e Senatit Akademik Nr. 321, datë 21.07.2022 "Për miratimin e tarifave vjetore të shkollimit për çdo program studimi dhe tarifave për rregjistrimin paraprak për vitin akademik 2022-2023", Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 26.07.2022,

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifave të shkollimit për vitin akademik 2022 – 2023 për programet e ciklit të parë, për programet e ciklit të dytë dhe programet profesionale të studimit sipas propozimit të Senatit Akademik në vendimin e sipërcituar.
Detajimi i nivelit të tarifave bashkëngjitur vendimit.
2. Miratimin e tarifave të rregjistrimit paraprak 1,600 lekë për të gjitha programet e studimit Bachelor dhe programet profesionale, 2,500 lekë për të gjitha programet e studimit Master, dhe 3,000 lekë për të gjitha programet e dyta të studimit. Tarifa e rregjistrimit për konkurim në programin "Edukim Fizik dhe Sporte" do të jetë 5,000 lekë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE E BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Alketa Zallëmi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1224 Prot.

Korçë, më 26.07.2022

VENDIM
NR. 332 DATË 26.07.2022

PËR
PËRFITIMIN E BURSËS NGA STUDENTËT, SIPAS PËRCAKTIMEVE TË VKM NR.
903, DATË 21.12.2016, "PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR PËRFITIMIN E
BURSAVE NGA FONDI I MBËSHETETJES STUDENTORE, PËR STUDENTËT E
SHKËLQYER, STUDENTËT QË STUDIOJNË NË PROGRAME STUDIMI NË FUSHAT
PRIORITARE DHE STUDENTET NË NEVOJË"
(e ndryshuar)

Bazuar në VKM Nr. 903, datë 21.12.2016, "Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore, për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programet studimi në fushat prioritare në nevojë", i ndryshuar, Bordi i Administrimit, i mbledhur në datën 26.07.2022, pasi shqyrtoi dokumentacionin vërtetues për statusin ligjor, të paraqitur nga studentë të vitit I, II dhe III të ciklit të parë të studimeve (Bachelor) dhe nga studentët e vitit I dhe II, të programeve të studimeve profesionale,

VENDOSI:

1. Të miratojë përfitimin e bursës për vitin akademik 2021-2022, për studentët e vitit I, II dhe III, të ciklit të parë të studimeve, "Bachelor" dhe nga studentët e vitit I dhe II, të programeve të studimeve profesionale, sipas listës emërore bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE E BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Alketa Zallëmi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1244 Prot.

Korçë, më 19.08.2022

VENDIM

Nr. 337, datë 19.08.2022

PËR
MIRATIMIN E PROGRAMIT BUXHETOR VJETOR DHE AFATMESËM
PËR PERIUDHËN 2023-2025

Bazuar në ligjin nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 49, pika 1 "c", Ligjin Nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", Ligjin nr.10 296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", Ligjin "Për buxhetin e vitit 2022" i ndryshuar, Udhëzimin nr.2 datë 06.02.2012 të Ministrisë së Financave "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", Udhëzimit "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm", Udhëzimin "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025", Bordi i Administrimit, i mbledhur në datën 19.08.2022, për miratimin e programit buxhetor vjetor dhe afatmesëm 2023-2025 konform synimeve dhe objektivave të përcaktuara në Strategjinë e Arsimit dhe Strategjinë kombëtare për shkencën, teknologjinë dhe inovacionin, 2021-2026, si dhe strategjinë kombëtare për zhvillim dhe integrim për periudhën 2021-2026,

VENDOSI:

1. Të miratojë programin buxhetor vjetor dhe afatmesëm 2023-2025 konform synimeve dhe objektivave të përcaktuara në Strategjinë e Arsimit dhe Strategjinë kombëtare për shkencën, teknologjinë dhe inovacionin, 2021-2026, si dhe strategjinë kombëtare për zhvillim dhe integrim për periudhën 2021-2026, pas propozimit të Senatit Akademik, miratuar me Vendimin e Senatit Akademik nr.336, datë 15.08.2022 me lëndë "Për miratimin paraprakisht të programit buxhetor vjetor dhe afatmesëm për periudhën 2023-2025".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Albëta Zallëmi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1429 prot

Korçë, më 23 / 09 / 2022

VENDIM

Nr. 391, datë 23.09.2022

PËR

**PËRCAKTIMIN E MASËS SË SHPËRBLIMIT TË PUNONJËSVE TË
UNIVERSITETIT**

Në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 67, pika 2, të Udhëzimit Nr. 29, datë 10.9.2018 "Për Veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në Institucionet e arsimit të lartë", pika 11, të Vendimit Nr. 329, datë 12.4.2017 "Për statusin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik", pika 2, pika 18, të "Statutit" të Universitetit "Fan S. Noli", datë 09.05.2008, i azhurnuar, neni 39, neni 74, pika 6, të "Rregullores së Buletinit Shkencor" të Universitetit "Fan S. Noli", neni 3, pika 5, "Rregullores së organizimit dhe veprimtarisë mësimore, kërkimore shkencore" të Universitetit "Fan S. Noli", Neni 36, pika 15, si dhe referuar "Kërkesës së Senatit Akademik Nr. 1211 prot., Datë 25/07/2022, për përcaktim shpërblimi të punonjësve të Universitetit "Fan S. Noli", Korçë." Bordi I Administrimit në mbledhjen e datës 23.09.2022,

VENDOSI:

1. Miratimin e shpërblimeve të punonjësve të Universitetit "Fan S. Noli", Korçë, për vitin 2022 dhe në vazhdim, sipas masave të përcaktuara në tabela bashkëlidhur.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE E BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Alketa Zallëmi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1735 Prot.

Korçë, më 28.10.2022

VENDIM

Nr. 496, datë 28.10.2022

**PËR MIRATIMIN E VENDIMIT TË SENATIT AKADEMIK Nr.491, DT 26.10.2022,
NR. 1711 Prot. PËR RIORGANIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT MASTER
PROFESIONAL NË "ZHVILLIM I INTEGRUAR RURAL", 60 ECTS NË MASTER
PROFESIONAL NË "DREJTIM AGROBIZNESI", 60 ECTS**

Bazuar në Ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" si dhe në Udhëzimin nr.1, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë" (i ndryshuar) të MAS, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 28.10.2022 vendosi:

VENDOSI:

1. Miratimin e Vendimit nr.491, datë 26.10.2022, Nr.1711 prot. për riorganizimin e programit të studimit Master Profesional në "Zhvillim i integruar rural", 60 ECTS në Master Profesional në "Drejt看 Agrobiznesi" 60 ECTS për Departamentin e Agrobiznesit për vitin akademik 2023 – 2024.
2. Ky program studimi do të financohet nga të ardhurat e institucionit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE E BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Alketa Zallëmi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1966 prot

Korçë, më 25/11/2022

VENDIM

Nr. 969, datë 25.11.2022

PËR

MIRATIMIN E NIVELIT MAKSIMAL TË PAGAVE TË PERSONELIT
AKADEMIK TË UNIVERSITETIT "FAN S. NOLI", KORÇË

Bazuar në ligjin nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Ligjin Nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", Ligjin nr.10 296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", Ligjin "Për buxhetin e vitit 2022", Udhëzimin nr.2 datë 06.02.2012 të Ministrisë së Financave "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", në zbatim të Vendimit Nr. 647, datë 5.10.2022, "Për disa ndryshime në vendimin nr. 748, datë 11.6.2009, të Këshillit të Ministrave", "***Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagën e punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të arsimit të lartë***", të ndryshuar, pika II / 2, referuar propozimit të Senatit Akademik Vendimi Nr. 558, date 21.11.2022, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 25.11.2022,

VENDOSI:

1. Miratimin e rritjes së pagave për të gjithë punonjësit e stafit akademik sipas nivelit maksimal të Lidhjes 1, kolona 3, të VKM 748, 11.06.2009, "***Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagën e punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të arsimit të lartë***" i ndryshuar.
2. Burimi financiar për rritjen e pagave mbi kufirin minimal deri në kufirin maksimal të përballohet nga të ardhurat e vetë institucionit, duke filluar nga muaji Tetor 2022.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Administratori dhe strukturat përgjegjëse të UNIKO
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Alketa Zallëmi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1964 Prot.

Korçë, më 25.11.2022

VENDIM

Nr. 572 datë 26.11.2022

PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT "MASTER I SHKENCAVE" NË
"STATISTIKË E APLIKUAR" ME 120 ECTS

Bazuar në Ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" si dhe në Udhëzimin nr.1, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë" (i ndryshuar) të MAS, si dhe vendimin e Senatit Akademik nr 554, datë 21.11.2022 "Për miratimin e hapjes së programit të studimit "Master i Shkencave" në "Statistikë e Aplikuar" me 120 ECTS", Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 25.11.2022 vendosi:

VENDOSI:

1. Miratimin e hapjes së programit të studimit "Master i Shkencave" në "Statistikë e Aplikuar" me 120 ECTS, për vitin akademik 2023 – 2024.
2. Ky program studimi do të financohet nga të ardhurat e institucionit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE E BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Alketa Zallëmi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1968 Prot.

Korçë, më 25. 11 .2022

VENDIM

Nr. 211, datë 25. 11 .2022

PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË PËRBASHKËT TË STUDIMIT "MASTER
PROFESIONAL" NË "MENAXHIM I QËNDRUESHËM NË AGROTURIZËM" ME 60
ECTS

Bazuar në Ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" si dhe në Udhëzimin nr.1, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësi kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë" (i ndryshuar) të MAS, si dhe vendimin e Senatit Akademik nr 555, datë 21.11.2022 "Për miratimin e hapjes së programit të përbashkët të studimit "Master Profesional" në "Menaxhim i Qëndrueshëm në Agroturizëm" me 60 ECTS", Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 25. 11 .2022 vendosi:

VENDOSI:

1. Miratimin e hapjes së programit të përbashkët të studimit "Menaxhim i Qëndrueshëm në Agroturizëm" me 60 ECTS", për vitin akademik 2023 – 2024.
2. Ky program studimi do të financohet nga të ardhurat e institucionit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE E BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Alketa Zallëmi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1969 Prot.

Korçë, më 25.11.2022

VENDIM

Nr. 572, datë 25.11.2022

PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT "BACHELOR" NË "GJUHË-LETËRSI
SHQIPE DHE GJUHË PAKICASH" ME 120 ECTS

Bazuar në Ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" si dhe në Udhëzimin nr.1, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë" (i ndryshuar) të MAS, si dhe vendimin e Senatit Akademik nr 556, datë 21.11.2022 "Për miratimin e hapjes së programit të studimit "Bachelor" në "Gjuhë-Letërsi Shqipe dhe Gjuhë Pakicash" me 120 ECTS", Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 25.11.2022 vendosi:

VENDOSI:

1. Miratimin e hapjes së programit të studimit "Bachelor" në "Gjuhë-Letërsi Shqipe dhe Gjuhë Pakicash" me 180 ECTS për vitin akademik 2023 – 2024.
2. Ky program studimi do të financohet nga të ardhurat e institucionit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE E BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Alketa Zallëmi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1970 Prot.

Korçë, më 25.11.2022

VENDIM

Nr. 573, datë 25.11.2022

**PËR RIORGANIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT "MASTER PROFESIONAL" NË
"MËSUES PËR ARSIMIN E MESËM PROFESIONAL" ME 120 ECTS, NË "MASTER I
SHKENCAVE" NË "EDUKIM NË STEAM" ME 120 ECTS**

Bazuar në Ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" si dhe në Udhëzimin nr.1, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësisve kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë" (i ndryshuar) të MAS, si dhe vendimin e Senatit Akademik nr 557, datë 21.11.2022 "Për riorganizimin e programit të studimit "Master Profesional" në "Mësues për arsimin e mesëm profesional", në "Master i Shkencave" në "Edukim në STEAM" me 120 ECTS" Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 25.11.2022 vendosi:

VENDOSI:

1. Miratimin e riorganizimit të programit të studimit "Master Profesional" në "Mësues për arsimin e mesëm profesional", në "Master i Shkencave" në "Edukim në STEAM" me 120 ECTS për vitin akademik 2023 – 2024.
2. Ky program studimi do të financohet nga të ardhurat e institucionit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE E BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Alketa Zallëmi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1971 Prot.

Korçë, më 25.11.2022

VENDIM
NR. 574 DATË 25.11.2022

**PËR
PËRFITIMIN E BURSËS NGA STUDENTËT, SIPAS PËRCAKTIMEVE TË VKM NR.
903, DATË 21.12.2016, "PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR PËRFITIMIN E
BURSAVE NGA FONDI I MBËSHTETJES STUDENTORE, PËR STUDENTËT E
SHKËLQYER, STUDENTËT QË STUDIOJNË NË PROGRAME STUDIMI NË FUSHAT
PRIORITARE DHE STUDENTET NË NEVOJË"
(e ndryshuar)**

Bazuar në VKM Nr. 903, datë 21.12.2016, "Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore, për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programet studimi në fushat prioritare në nevojë", i ndryshuar, Bordi i Administrimit, i mbledhur në datën 25.11.2022, pasi shqyrtoi dokumentacionin vërtetues për statusin ligjor, të paraqitur nga studentë të vitit I, II dhe III të ciklit të parë të studimeve (Bachelor) dhe nga studentët e vitit I dhe II, të programeve të studimeve profesionale,

VENDOSI:

1. Të miratojë përfitimin e bursës për vitin akademik 2021-2022, për studentët e vitit I, II dhe III, të ciklit të parë të studimeve, "Bachelor" dhe nga studentët e vitit I dhe II, të programeve të studimeve profesionale, sipas listës emërore bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE E BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Alketa Zallëmi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1942 Prot.

Korçë, më 25. 11. 2022

VENDIM

Nr. 575 datë 25. 11. 2022

PËR

MIRATIMIN E DETAJIMIT TE FONDEVE BUXHETORE PËR VITIN 2022

Bazuar në ligjin nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 49, pika "a", "ë", Ligjin Nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", Udhëzimin e përbashkët Nr. 20 datë 20.09.2019 të MASR dhe MFE "Për skemën dhe zbatimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor", VKM Nr.75, datë 12.02.2018 "Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor" Bordi i Administrimit të Universitetit "Fan S. Noli", në mbledhjen e datës 25.11.2022, referuar Shkresës Nr. 5164/2 Prot, datë 02.08.2022 të MAS, lënda "Rishpërndarje e fondeve për Projektin në kuadër të Ndërkombëtarizimit të Programeve të Studimit për vitin akademik 2022 – 2023 *"Evidentimi, ruajtja, përmiresimi dhe përdorimi i resurseve gjenetike autoktone të bimëve të rajonit"* dhe Shkresës Nr. 19791/1 Prot., datë 31.10.2022 "Efektet e rritjes së pagave në zbatim të VKM nr. 647, datë 05.10.2022, VKM nr. 621, datë 28.09.2022 dhe VKM nr. 627, datë 28.09.2022 për miratimin e ndarjes së grantit buxhetor, alokuar nga buxheti i shtetit për vitin 2022:

VENDOSI:

Miratimin e ndarjes së fondeve të akorduara nga buxheti i shtetit për vitin 2022, grantit të mësimdhënies.

- Projekti në kuadër të Ndërkombëtarizimit të Programeve të Studimit për vitin akademik 2022 – 2023 *"Evidentimi, ruajtja, përmiresimi dhe përdorimi i resurseve gjenetike autoktone të bimëve të rajonit"*
- Efektet financiare nga rritja e pagave referuar VKM nr. 647, datë 05.10.2022, VKM nr. 621, datë 28.09.2022 dhe VKM nr. 627, datë 28.09.2022.

(Materialet përkatës bashkëngjitur këtij Vendimi)

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE E BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Alketa Zallëri